

Dokumentacioni teknik për projektet e objekteve shtetërore që rikonstruktohen

- Kërkesa e zhvilluesit për kryerjen e oponencës;
- Detyra e projektimit e miratuar nga zhvilluesi (origjinale ose kopje e njësuar me origjinalin);
- Marrëveshja midis zhvilluesit dhe sipërmarrësit të hartimit të projektit;
- Relacioni teknik mbi gjendjen ekzistuese të objektit, shoqëruar me fotot përkatëse;
- Projekti arkitektonik ekzistues;
- Projektideja e miratuar nga zhvilluesi;
- Projekti konstruktiv ekzistues, llogaritjet konstruktive analitike për objektin ekzistues; llogaritjet analitike në formë elektronike;
- Projekti arkitektonik + relacioni teknik + projekti ne DWG
- Studimi gjeologo-inxhinierik i sheshit të ndërtimit i rifreskuar
- Studimi inxhiniero-sizmiologjik , për objekte mbi tetë kate ose vërtetimi nga Instituti i Sizmiologjisë për objekte nën tetë kate;
- Projekti hidrosanitar + MKZ + Ngrohje ventilim i firmosur nga inxhinieri hidroteknik (kanalizime, ventilim, ngrohje, mbrojtje nga zjarri) dhe relacioni përkatës;
- Projekti elektrik i firmosur nga inxhinieri elektrik dhe relacioni përkatës;
- Preventivi i objektit i firmosur nga grupi preventivues dhe zhvilluesi;
- Certifikata e përkohshme e performancës së energjisë;
- Specifikime teknike.
- Në rastin kur mungon projekti konstruktiv ekzistues, kërkesa shoqërohet me aktekspertizën teknike të gjendjes ekzistuese të objektit, hartuar nga një grup specialistësh të licencuar sipas fushave përkatëse, të miratuar nga zhvilluesi, shoqëruar dhe me fotot e gjendjes ekzistuese në pjesën e jashtme të objektit (fasadat) dhe pjesët e brendshme.
- Dokumentacioni ligjor i nevojshëm përfshin :
 - licencat përkatëse të personit juridik apo fizik projektues/projektuesit;
 - dëshmitë e kualifikimet përkatëse;
 - policën e sigurimit;
 - deklaratën e përgjegjësisë profesionale të projektuesit;
 - kontratën e shërbimit midis zhvilluesit dhe investitorit.
- Materialet duhet të jenë në gjuhën shqipe
- Të gjitha materialet duhet të jenë të firmosura nga autorët dhe shoqëria projektuese (ose Enti Investitor)
- Nevojitet miratimi nga ana e Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit për objektet të cilat ndodhen në Zonat e Mbrojtura, si dhe për ato objekte që janë Monumente Kulture.
- Dokumentacioni i përcaktuar paraqitet në formë hard copy ose elektronike.